



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ___ / ___ / 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “**Miki Consulting**” sh.p.k., me adrese: Qendra “Skodrinon”, Rr. “Vaso Kadia”, Nr. Pas. 1/506

Procedura e prokurimit/lotit: “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Loti II REF-83067-10-10-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti II : Mbikëqyrje e objektit "Riparim i argjinaturës mbrojtëse të Përroit Zaranikë"** me fond limit **174,655** (njëqind e shtatëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2023, me afat 40 ditë për kryerjen e shërbimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “MIKI CONSULTING” sh.p.k. me Nipt: K 87628701 K

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **158.777,5** (njëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë presje pesë) **lekë** (pa tvsh).

2. " Novatech studio " sh.p.k. me Nipt: L01717030C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **150.016,44** (njëqind e pesëdhjetëmijë e gjashtëmbëdhjetë presje dyzet e katër) **lekë** (pa tvsh).

3. "PROJECT DALUZ 2019 " sh.p.k. me Nipt L92112031B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **162.180** (njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Ofertues të skualifikuar ka.

1 – Novatech sh.p.k. me Nipt: L01717030C

Subjekti juaj skualifikohet për arsye se:

Subjekti juaj ka ofertuar me çmim më të ulët se vlera minimale e lejuar bazuar në rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5585 prot., date 25.07.2017, "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", e për pasojë oferta e juaj refuzohet.

Oferta juaj s'kualifikohet për arsyen e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Miki Consulting”** sh.p.k., me adrese: Qendra “Skodrinon”, Rr. “Vaso Kadia”, Nr. Pas. 1/506, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **158.777,5** (njëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë presje pesë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, **Bashkia Elbasan** me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Aulona Bylykbashi